



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA DRENAS

RAPORTI I PUNËS JANAR - QERSHOR 2015 I KRYETARIT TË KOMUNËS

DRENAS, SHTATOR 2015

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Zyra e Kryetarit - Në raportin gjashtë mujor të kryetarit janë pranuar 635 kërkesa nga qytetarët të cilave iu është përgjigjur, ndërsa zyra e kryetarit ka organizuar edhe një takim me publikun, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Kryetari i Komunës ka mbajtur takime të rregullta (një herë në javë) me Bordin e Drejtorëve dhe ka diskutuar çështjet e ndryshme dhe kërkesat e qytetarëve. Ndërsa janë mbajtur edhe 3 mbledhje me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb). Nënkryetari i Komunës ka mbajtur takime me përfaqësuesit e fshatrave dhe ka marr nga ta kërkesat e ankesat dhe ka diskutuar për çështje të ndryshme.

Zyra për Informim - Zyra e Informimit gjatë periudhës raportuese, ka përcjellur aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut zyrtar <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, web faqës së Komunës, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar; vendimet, rregulloret, raportet, projektet, konkurset, njoftimet e prokurimit, njoftimet tjera të ndryshme dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellur njoftime e lajme për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ka përcjellë ftesa, reagime etj. Ka përcjellur agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal si dhe me delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Ka pranuar kërkesa të qytetarëve që i janë adresuar Kryetarit të Komunës dhe në afatin ligjor janë kthyer përgjigjet. Në kuadër të transparencës komunale janë pranuar në këtë periudhë raportuese 32 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe në afatin ligjor i janë përgjigjur të gjitha kërkesave në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullorës Komunale të Transparencës.

Zyra e Auditorit të Brendshëm - Njësia e Auditimit të Brendshëm ka të miratuar Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2015 -2017. Poashtu kjo Njësi ka të miratuar edhe Planin e Punës për vitin 2015. Me plan të punës për vitin 2015 janë të parapara 8 auditime. Deri me 30.06.2015 janë finalizuar gjithësej 4 Raporte të auditimit. Synimet kryesore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm kanë qenë;

- Arritja e pajtueshmërisë me kornizën ligjore në fuqi
- Rritja e Efikasitetit, Efektivitetit dhe Ekonomizimit gjatë shpenzimit të buxhetit komunal
- Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me pasuritë e Komunës,
- Rritja e vlerës së burimeve material dhe humane,
- Rritja e sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara në pasqyrat financiare të Komunës, etj.

Të gjitha raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe janë nxjerrur konkluzat për hapat që duhet të ndërmerren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrur një qasje gjithpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e Komunës. Gjatë këtij aktiviteti janë zhvilluar intervista me menaxherët dhe kemi shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarrur në këtë drejtim. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore të vitit 2015 ka finalizuar katër raporte dhe ka dhënë rekomandime.

Gjendja e rekomandimeve të dhëna është:

- Gjithësej janë dhënë 30 rekomandime,
- Të implementuara 9 rekomandime,
- Pjesërisht të implementuara 7 rekomandime,

- Të pa implementuara 8 rekomandime, dhe
- Gjashtë rekomandime nuk kanë ende periudhë krahasuese për të vërtetuar implementimin e tyre.

Ne inkurajojmë menaxhmentin që edhe më tutje të shtoi aktivitetet e tyre për jetësimin e rekomandimeve që janë në proces të implementimit apo ato të pa ardesuara. Gjithashtu falenderojmë menaxherët të cilët kanë arritur që të implementojnë rekomandimet tona të dhëna deri më tani.

1- DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtorja e Administratës ka kaluar nëpër fazë të sprovave dhe sfidave të konsiderueshme dhe ka përshpejtuar hapat për realizimin e objektivave dhe detyrave të planifikuara. Sidomos në punën më efikase dhe efektive të ZPP, duke përfshirë brenda një shpalljeje tenderuese të disa projekteve të ngjashme me loto të ndara. Kjo për arsyen e përfshirjes të të gjitha projekteve kapitale në procedura të shpalljeve dhe vlerësimeve, për të evituar ngecjet në realizimin e projekteve kapitale. Në Sektorin e Gjendjes Civile ka ndryshuar sistemi dhe ai po zbatohet me rregull, pasi që i janë nënshtruar trajnimit zyrtarët përkatës. Ky shërbim po ballafaqohet me mungesë stafi për zhagjitje apo vonesë të procedurave rekrutuese. Megjithatë, nga 33359 lëndë të përgjithshme, 22257 janë nga ky sektor. Ajo që ka shkaktuar rritjen e numrit të lëndëve në këtë sektor ka qenë një eufori e kërkesave për pajisje me dokumente të gjendjes civile në janar dhe shkurt, kur edhe ndodhi euforia e ekzodit të madh drejt Perëndimit. Asokohe janë lëshuar qindra dokumente të tilla brenda ditës. Po ashtu ka ecur edhe aplikimi online për qytetarë pas instalimit nga ana jonë dhe është i qasshëm 24/7 orë për qytetarë. QShQK-ja ka pranuar 33359 lëndë dhe numri i lëndëve të shqyrtuara në përqindje na del pak më i vogël se sa gjendja reale, pasojë edhe kjo e mosgjenerimit të të dhënave, si në DAP, dukuri kjo që po përsëritet me lëshime që bien mbi zyrtarët e sistemit të dikasterit ministror. Ata kanë ndërhyrë pas këmbëngultësisë tonë, duke përmirësuar statusin e numrit të lëndëve, por megjithatë shkaktarin nuk e kanë identifikuar, edhe pse janë menaxhues të sistemit.

Spektori i Përgjithshëm: -NJKDNJ: Nga 13 pozita vendimmarrëse politike dominojnë meshkujt, kurse vetëm 1 Drejtori e udhëheq femra. Institucione shkollore drejtojnë 3 femra/ 29 meshkuj, zvdrejtor/e 1 femër/ 3 meshkuj, ato shëndetësore 1femër (QKMF), 1 mashkull (QPS).

Tek shërbyesit civilë janë 31 shefa në administratën komunale: 10 femra/21 meshkuj.

Nga gjithsej të punësuar në sektorin publik 1332 (399 f/933 m), staf civil janë 1319 (398 f /921 m):

Spektori	Nr i tërësishëm	Femra	Meshkuj
Administratë	155	43	112
Arsim	964	249	715
Shëndetësi	200	106	94
Gjithsej:	1319	398	921

Zyra e Prokurimit Publik:**a. Gjatë periudhës 01.01.2015 deri më 30.06.2015 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë 683 kërkesa nga të cilat:**

1. Administrata komunale 501
2. Institucionet arsimore 144 dhe
3. Institucionet shëndetësore 38
4. Rexhistrim të faturave 688
5. Nxjerrja e urdhërblërjeve 690

b. Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar 89 procedura, prej tyre për:

1. Vlera minimale 13
2. Kuotime të çmimeve 24
3. Punë shtesë 2 dhe
4. Procedura të hapura 40 (punë 28, furnizime 12)
5. Anulime dhe Ri-tenderime të njoftimeve për kontratë 7.

c. Janë nënshkruar 73 kontrata, prej tyre për:

1. Vlera minimale 13
2. Vlera të vogëla 24
3. Punë shtesë 1 dhe
4. Vlera të mesme ose të mëdha 35
- 5.

1. Sektori i Gjendjes Civile

Nr.r	Lloji i dokumentit	Sasia
1	Certifikata të lindjes	2687
2	Ekstrakte të lindjes	16025
3	Certifikata të martesës	1963
4	Certifikata të vdekjes	700
5	Certifikata të statusit martesor	993
6	Deklarata të bashkësisë familjare	1932
7	Certifikata të shtetësisë kosovare	260
8	Certifikata të vendbanimit	478
	Gjithsej	25038
	Lloji i regjistrimit	
	Regjistrimet: Lindje, Kurora, Vdekje	
1	Lindje –regjistrime të reja	56
2	Lindje –regjistrime të mëvonshme	161
3	Martesa –regjistrime të reja	335
4	Martesa –regjistrime të mëvonshme	217
5	Vdekje –regjistrime të rregullta	52
6	Vdekje –regjistrime të mëvonshme	76
	Gjithsej	680

Qendra për Shërbime të Qytetarëve/ QSHQK



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA GLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

Report i datës 01/01/2015 deri 30/06/2015

Nr.	Departamenti	Në pritje për pranim	Të pashqyrtuara	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pesulhuar	Totali
1	01-Prezidenca	0	136	19	383	95	2	0	635
2	02-Drejtoria për Administratë dhe Personel	0	986	4	21116	6	155	0	22267
3	03-Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet	0	0	1	3951	1	8	0	3961
4	04-Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	0	0	105	521	1	0	0	627
5	06-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	0	13	78	607	0	1	0	699
6	07-Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	0	1	1	3472	7	8	0	3489
7	08-Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Zhvillim	0	0	5	366	3	2	1	377
8	09-Drejtoria për Ansam dhe Shitësi	0	346	7	67	2	1	0	423
9	10-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	101	0	0	0	0	0	101
10	11-Drejtoria për Punë të Inspeksionit	0	79	26	285	0	2	0	392
11	12-Zyra e Kuvendit Komunal	0	0	72	85	1	0	0	168
12	13-Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	0	3	74	136	1	0	0	214
13	14-Zyra Komonale për Komunitete e Kthim	0	2	8	4	2	0	0	16
Gjithsej:		0	1667	400	30993	119	179	1	33359

Nr. faqes: 1

Data e printimit: 13/07/2015

Në tabelën e mëposhtme po japim të dhënat për pranimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, drejtuar organeve të komunës, sipas njësive organizative.

Departamentet		Kërkuesit					
01/ 02/ 03/ 04/ 05/ 06/ 07/ 08/ 09/ 10/ 11/ 12/ 13	Kerkesë nga palët	Ankesë nga palët	Kërkesë nga Institucionet	Ankesë nga Institucionet	Oferetë	Tjera	Gjithsej
01-PR	163	110	119	2	68	173	635
02-DAP	21,320	5	33	2	0	907	22,267
03-DEBF	253	5	9	0	1	3,693	3,961
04-DBZHR	112	3	6	0	2	504	627
06-DSHMS	385	6	5	1	5	297	699
07-DGJPK	2,185	9	9	0	0	1,286	3,489
08-DUPZH	193	1	28	1	0	154	377
09-DASH	60	18	23	0	22	300	423
10-DKRS	44	1	8	0	3	45	101
11-DPI	33	3	4	0	0	352	392
12-ZKK	54	3	6	0	29	66	158
13-DSHPS	136	1	12	0	0	65	214
14-ZKKTH	7	1	3	0	0	5	16
Gjithsejt	24,945	166	265	6	130	7,847	33,359

2- DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në planëprogramin e punës dhe duke u mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-049 dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë paraqesim raportin e gjashtëmuorit të parë për vitin 2015, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit mbart mbi vete shumë aktivitete në sektorin e planifikimit hapësinor si dhe në sektorin e projekteve si: hartimin e projekteve zhvillimore, planeve urbane, lejeve ndërtimore dhe investimet kapitale.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT

Në sektorin e planifikimit jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të mirën e qytetit. Gjatë gjashtëmuorit të parë për vitin 2015 ka filluar të aplikohet edhe Ligji për Legalizime, ku me kohë kemi bërë përgatitjet dhe trajnimin e stafit për procedurat së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ndërsa si Komunë jemi ndër të parat që kemi filluar me përpilimin e listës së ndërtimeve pa leje. Sipas të dhënave të Drejtorisë, Drenasi me fshatra ka rreth 11900 ndërtime pa leje duke përfshirë edhe ato para luftës. Gjithashtu në harmoni me Planin Zhvillimor dhe Plain Rregullues kemi shqyrtuar kërkesat brenda afatit ligjor, si dhe me kohë ju kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e marrura.

Tabela e ecurive të lëndëve

Nr	Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve	Pranuara	Aprovuara	Refuzuara	Në Proces
1	Leje Urbanistike	10	8	2	x
2	Leje ndërtimi	12	11	x	1
3	Leje rrenimi	1	1	x	x
4	Leje per lokacion (per trafo, loja,terasa)	26	24	2	x
5	Pëlqime (Infrastruktur, Bashkimparcelave,Urbanistike)	74	74	x	x
6	Lëshimi i lejeve së përkohshme për aktivitet një ditor	1	1	x	x
7	Kërkesa tjera për financimin e projekteve për nevojat e qytetarëve në infrastrukturë	374	366	3	5
Totali:		498	485	7	6

Gjithashtu për punimin e kërkesave për banesa, kontrata të ndryshme, shitëblerje etj. Klasifikimi, renditja dhe regjistrimi i lëndëve dhe projekteve të drejtorisë (të gjitha me numër dhe emër në databazën e krijuar në drejtori). Hartimi i taksës për leje ndërtimi dhe taksës së densitetit të infrastrukturës, hartimi i aktvendimeve të ndryshme si për mbikëqyrje dhe pranime teknike të projekteve kapitale, përgatitja e dokumentacionit për pranimin teknik të rrugëve dhe projekteve kapitale në Komunën e Drenasit.

AKTIVITETET

- Përgatitja dhe dorëzimi i projekteve kapitale të komunës në Ministrinë e Infrastrukturës ;
- Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale;
- Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e Drejtoratit për PUMM.
- Mbikëqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale;
- Hartimet e raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikqyrësit e projekteve kapitale;
- Njoftime të ndryshme për palë rreth kompletimit të lëndëve;
- Takime me përfaqësuesit e Komisionit Evropian për Kosovë për Efiqencë të Energjisë;
- Seminari dyditor me përfaqësuesit e Komisionit Evropian në Kosovë për Efiqencë të Energjisë
- Takimi në Mitrovicë për hartimin e Programit të Banimit Social, -
- Takimi me përfaqësuesit e Ujësllësit Rajonal dhe CDI zviceriane në Prishtinë dhe caktimi i prioriteteve për projektet e ujësllësit dhe kanalizimit që duhet të dorëzohen.

SEKTORI I PROJEKTEVE - Gjatë realizimit të buxhetit komunal për projektet kapitale që janë paraparë për realizim në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, ne si drejtori jemi angazhuar me tërë stafin që të realizojmë projektet kapitale dhe hartimin e planeve të nevojshme komunale. Të gjitha projektet kapitale si: rrugët, trotuarët, ujësllësit, kanalizimet, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ura, mure mbrojtëse, gropa septike, renovime etj që janë realizuar gjatë këtij gjashtëmujori janë kryer sipas kontratave dhe pjesa tjetër e projekteve është në procedurë. Ndërsa cilësia është në përgjithësi e kënaqshme dhe jemi angazhuar si drejtori që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive dhe kapaciteteve që i kemi në dispozicion.

PROJEKTET KAPITALE QË JANË REALIZUAR GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2015

LISTA E PROJEKTEVE TE REALIZUARA PER VITIN 2015,NGA DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TE MJEDISIT		
PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS - ASFALTIMET		
Nr	Emertimi i Projektit	Gajtësia e rrugëvetërealizuaranë m'
1	ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN ABRI -(LAGJET SYLKAJ, HAJDARAJ, HYSEN.AJ DHE MULIQI)	1364.00
2	ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLË	1513.00
3	ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN KORROTCË E EPËRME (LAGJA	437.00

	DOBËRDALANI, CURRI DHE HOTI) DHE VASILEVË	
	ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN VASILEVE	700.00
4	ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN TËRDEC	700.00
5	ASFALTIMI I RRUGËVE LOKALE NË FSHATIN SHTUTICË -(LAGJA MALAJ, SYLAJ DHE BALIU)-FAZA E DYTË	1200.00
6	ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN POLLUZHE	300.00
7	ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN GLOBOAR	516.00
8	INFRASTRUKTURA NË QYTETIN E DRENASIT -ASFALTIMI I RRUGËVE	550.00
9	ASFALTIMI I RRUGËS NE FSHATIN POKLEK (LAGJA CARAVADUKU DHE BUCOLLI)	1440
10	ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN KIZHAREKË	400.00
11	ASFALTIMI I RRUGËS NË KROJKOVË LAXHA HOXHAJ	800
	Totali i përgjithshem përAsfalitim	9920 m

PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS - KANALIZIMET

Nr	Emërtimi i Projektit	Gjatësia ekanalizimevetë realizuara në m'
1	KANALIZIMI I UJËRAVE TE ZEZA NE FSHATIN TERSTENIK II-LAGJA GJOKA - VAZHDIM I PUNIMEVE	480.00
2	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN BYTYQ	2300.00
3	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN DOBROSHEVC (LAGJA SHEHU, PRENKU DHE XHOTA	3320.00
4	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN NEGROC	3000.00
5	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NE FSHATIN VASILEVË-FAZA E TRETË	1800.00
6	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN TËRDEC	900.00
7	KANALIZIMI I UJRAVE TE ZEZA NE FSHTATIN ZABEL I EPËRM	1100.00
8	KANALIZIMI I UJËRAVE TE ZEZA NE FSHATIN KIZHAREKË	900.00

9	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN KROJKOVË	1000.00
10	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN TËRSTENIKU II (LAGJA MULAJ, SPAHIJA DHE KUKAJ)	1800.00
11	MIRËMBAJTJA E KANALIZIMEVE NË KOMUNËN E DRENASIT	750.00
12	KANALIZIMI UJRAVE TE ZEZA NE KORROTICE TE EPERME (LAGJA DOBËRDALANI, CURRI DHE HOTI)	437.00
13	KANALIZIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN ÇIKATOVË E VJETER	2200
Total i përgjithshëm për Kanalizim m'		21437 m

Projekte tjera të realizuara

- Rregullimi i Infrastrukturës në Lagjen e Dëshmorëve në Paklek i Ri.
- Ndërtimi i shtëpive për skamnore (furnizim me material ndërtimor për 37 familje skamnore).
- Ndërtimi i trotuarit në fshatin Shtrubullovë
- Ndërtimi i rrugëve me kubza në rrugët e qytetit të Drenasit,
- Projekte tjera kapitale të komunës (Hartimi i projekteve zbatuese për shkollat: Llapushnik, Komoran, Kizharekë)

Gjithashtu kemi përgatitur me kohë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për investime kapitale për vitin 2016, kemi mbajtur takime me administrator të fshatrave, kemi marrë kërkesat për investime të cilat i kemi paraqitur para Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendit Komunal. Prioritet jemi munduar t'i japim projekteve të mbetura gjysmë dhe disa projekte që kanë qenë të domosdoshme. Në prioritet kemi vënë një numër të madh kanalizimesh në krahasim me vitin që lamë pas, e që ishin edhe kërkesat e qytetarëve të dalura nga takimet e mbajtura në bashksi lokale.

PROJEKTET KAPITALE TË PËRFITUARA NGA DONACIONET ME BASHKËFINANCIM ME KOMUNËN E DRENASIT

Ministria e Infrastrukturës –Asfaltimi i rrugës në fshatin Kizhnarekë 56,927.50 €

Ministria e Pushtetit Lokal

- Ndërtimi i Kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Poklek i Ri 23,224.50 €
- Rehabilitimi i SHFMU “Rasim Kiqina” me IOM-in 200,000.00 €
- Rregullimi i ndriçimit solar me :
- UNDP-n 10,000.00 €
- KK Drenas 40,000.00 €

- Ministria e Infrastruktures (Asfaltimi i rrugës në fsh. Krajkovë- L. Hoxhaj) 100.000.00€
- Ndërtimi i rrugës Abri-Terdevc-Gullubovc në gjatësi prej 4.5 km 830.000.00€
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
 - Financimi i ujësjellësit në fshatin Arllat dhe Gjergjic; në vlerë prej 115.000.00€
 - Zgjerimi i shtratit të lumit Drenica në vlerë prej 640.000.00€

Me angazhimin e stafit të drejtorisë dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës kemi arritur që t'i financojmë këto projekte kapitale dhe jetike për qytetarët e Drenasit edhe jashtë mundësive bugetore të Komunës dhe me seriozitet dhe profesionalizëm kemi arritur që t'i bindim këta donator që këto mjete t'i investojnë në Drenas.

VËSHTIRËSIT GJATË REALIZIMIT TË PUNËVE TË DREJTORATIT - Duhet të theksohet që gjatë realizimit të mbikëqyrjes së projekteve në teren, po ashtu edhe punëve në zyrë jemi ballafaquar me vështërsi të natyrave të ndryshme, kemi pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme, si moslejimi i realizimit të projekteve në pronat private dhe publike e deri te pengimi i realizimit të projekteve. Këto vështërsi kanë ndikuar në realizimin e planeve dinamike për permbushjen e objektivave dhe planeve të parapara nga Drejtoria e Urbanizmit. Besoj që me angazhimin maksimal që në këtë gjashtëmujor do të arrijmë ti kryejmë të gjitha projektet e parapara për viti 2015. Po ashtu më këtë staf të vogël që ka drejtoria kemi vështirësi të shumta në realizimin e të gjitha këtyre projekteve kapitale. Vëllimi i punëve, kërkesat e shumta të qytetarëve dhe mundësit e vogla buxhetore nuk mjaftojnë të realizohen dhe trajtohen financiarisht nevojat dhe kërkesat e të gjitha fshatrave të komunës sonë.

REKOMANDIMET - Ne si drejtorat rekomandojmë që për realizim të suksesshëm dhe mbikëqyrje sa më cilësore, të bëhet kompenzim i zyrtarëve komunal të cilët marrin pjesë në hartimin dhe mbikëqyrjen e projekteve. Po ashtu, duhet të rritet numri i punëtorëve profesional në këtë drejtori në mënyrë që të rritet cilësia në realizim të projekteve kapitale.

3- DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Raporti i punës së Departamentit për Arsim (DKA) paraqitur Kryetarit të Komunës, përfshinë periudhën prej muajit janar-qershor 2015. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Departamenti janë realizuar më përkushtim dhe më përgjegjësi. Procesi arsimor gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimisht i përcjellur me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHT-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë. Ndërsa për Konferencën e Donatorëve Ndërkombëtarë janë përgatitur projekte ideore në formularët zyrtar të sjellur me internet nga Qeveria. Për konferencën e donatoreve kemi përgatitur 25 projekte.

STRUKTURA ORGANIZATIVE e DKA-së

Këtë sektor e përbëjnë 10 punëtorë: Drejtori, një zyrtar për personel, dy zyrtarë për Arsim, një pedagog, një psikolog, një zyrtar për financa, një zyrtar për prokurim, një zotues dhe një depoist. Drenasi ka një çerdhe, 29 shkolla fillore dhe të mesme të ultë, 5 paralele të ndara, dy shkolla të mesme gjithsejtë 37 institucione shkollore, ku punojnë gjithsejtë 964 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 13.849 nxënës. 54 punëtor administrativ, 796 mësimdhënës, 131 punëtor teknik, Çerdhja "Ardhmëria" ka gjithsejtë 136 fëmijë, shkollat fillore të prej (I - IX) ka gjithsejtë 10891 nxënës, Gjimnazi "Gj.K.Skënderbeu" ka gjithsejtë 1489 nxënës, Shkolla e Mesme Teknike ka gjithsejtë 1333 nxënës.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS

Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore në Drenas. Në këto takime kemi kërkuar angazhim edhe më të madh të punëtorëve, sidomos në ngritjen e cilësisë në arsim në vitin shkollor 2014-2015, dhe kemi kërkuar respektimin në përpikëri të ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerrura nga MASHT-i. Kemi realizuar takime me prindër, kemi marrë pjesë në manifestimin në Ditën e shkollës në disa shkolla. Aktivitet që ka përfunduar më sukses është edhe kuizi komunal i organizuar në të gjitha shkollat e nivelit të mesëm të ulet d.m.th. (6-9), ku është treguar ky sukses: Në vendin e parë SHFMU „Xhevë Lladrovci” Gllanasell, në vendin e dytë SHFMU "Bajram Curri" Nekoc, në vendin e tretë SHFMU „Naim Frashri” Gllobar. Vizita kemi realizuar edhe në institucionet parashkollore, QEAP "Ardhmëria" në Drenas dhe Bushat. Testi i Arritshmërisë me klasë të nënta është përgatitur më kohë sipas planifikimit të MASHT, në test morën pjesë 1262 nxënës, kaluan testin 65 % e nxënësve. Janë nënshkruar 30 marrëveshje për praktiken profesionale me ndërmarrje të vogla për praktiken profesionale të nxënësve, me Ndërmarrja NeëCo Feronikeli kemi filluar bashkëpunimin për të kryer praktiken profesionale nxënësit e SHMP "FEHMI LLADROFCI"

DONACIONET - Ka filluar renovimi i SHFMU "RASIM KIÇINA" Drenas, investim i IOM. Projekti "Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit dhe mësimi elektronik në Arsim", për Gjimnazin, "Gj.K. Skenderbeu", Investim i BE-së. Në SHFMU „Shotë Galica" në Tërdec OJQ më seli në Shkup i ka dhuruar shkollës inventar, lekturë shkollore, kompjuter në vlerë 4000 mijë euro. Në SHFMU "Rilindja" në Dritan, disa bashkëfshatar i kanë dhuruar shkollës dhjetë kompjuter të ri. Në SHFMU "Xhevë Lladrovci", donacion nga NewCo Feronikeli, për kabinetin e lëndës së kimisë, dhe çanta për 40 nxënës të kësaj shkolle.

INVESTIMET KAPITALE - Ka filluar renovimi i SHFMU "Xheladin Gashi-Plaku", Komoran, investim i MASHT-it. Ka filluar ndërtimi i aneksit të shkollës "7 MARSII", Kizhnarekë, investim i MASHT-it, ka filluar renovimi i SHFMU "Shaban Poluzha" Korroticë e Epërme, investim i MASHT-it, ka filluar të rregullohet infrastruktura e oborrit të shkollës dhe terrenet e sportit në SHFMU "Naim Frashri" Gllobar, investim i MASHT-it. Ka filluar ndërtimi i fushave të sportit në këto shkolla, "Migjeni" Baicë, "Shotë Galica" Grykas, "Xhevë Lladrovci" Gllanasellë, "Zenel Hajdini" Terstenik, "Bajram Curri" Nekoc dhe "Fazli Greiqevci" Vasilevë, investime të Komunës.

KOMUNIKIMI ME MASHT-in - Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in. Ndërsa në kërkesat tona për investim kapitale janë realizuar pesë prej tyre, ku edhe kanë filluar punimet në katër prej tyre. Në çdo mbledhje me drejtorë të departamenteve për Arsim janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marruar detyra nga MASHT-i.

BASHKËPUNIMI ME BE-në - Edhe në këtë vit kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me BE-në për interesin e përgjithshëm të arsimit në Drenas, (BEP, GIZ-in) USAID, etj. Po vazhdon certifikimi edhe i kandidateve të tjerë për drejtor të institucioneve arsimore në Programin për Udhëheqje dhe Menaxhim të Shkollës. Janë certifikuar 90% e mësimdhënësve nga projekti i BE-së i plementuar nga Gizi në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimdhënësve po vazhdojnë edhe gjatë këtij viti shkollor.

VËSHTRËSITË- Vështirësitë janë edhe obligimet financiare të mësimdhënies të pa pagurë gjatë zavëndesimeve të pushimeve mjekësore, (pushimet e lehonave). Stafi profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

PËRFUNDIM - Jemi të vetëdijshëm për sfidat që kemi përpara vetës, edhe në këtë vit angazhimi ka qenë edhe në ditë të vikendit e sidomos gjatë ditëve të trajnimit të mësimdhënësve, vetëm e vetëm që në Drenas të ngritët cilësia në arsim. Për të krijuar kushte dhe mundësi të reja në rrethanat e reja shtetërore që sot e nesër të kemi shkolla efektive dhe funksionale në kuptimin e plotë të fjalës, vlen që të gjithë të angazhohemi për ta ngritur sa më lartë cilësinë në arsim.

4 - DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Kjo Drejtori gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha lëmit përkatëse që janë kompetencë e sajë, në bazë të Statutit të Komunës ku është obligim dhe përgjegjësi e kësaj Drejtorie, që të zbatojë dispozitat ligjore lidhur me të gjitha lëmitë që janë në kompetencë të sajë. Në komunën e Drenasit bujqësia po shendërrohet në një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, dhe duke patur parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe në at klimatik. Duke pas parasysh këto dukuri komuna e Drenasit ka për qellim që të zgjerojë kapacitetin e zhvillimit bujqësor ku nëpërmes saj do të hapen vende të reja të punës e po ashtu si qellim kryesor do të jetë rritja e prodhimeve vendore dhe ulja e importit.

Gjithashtu janë bërë reforma të volitshme në politikat administrative dhe fiskale për të gjitha bizneset që operojnë Komunën e Drenasit duke krijuar një ambient të volitshëm për investitor të ndryshëm. Edhe Parku i Biznesit është zhvilluar me një dinamikë më të shpejtë duke ju përmbajtur Kontratave të nënshkruara nga subjektet afariste, kompanitë që janë të vendosura në ambientet e kësaj zone që ka një pozitë shumë strategjike, kështu që në këtë periudhë raportuese janë duke i përmbyllë projektet e veta edhe 10 kompani që gjithsejtë do të kemi 40 kompani të vendosura në PBD.

SEKTOR I BUJQËSISË KA KRYËR KETO PUNË :

- Këshillimet për fermer rreth aplikimit për Grande të ndryshme, në sektorët e ndryshëm të bujqësisë, si dhe kompletimi i të gjithë dokumentacionit të këtyre fermerëve për të aplikuar në MBPZHR.
- Këshillimet për fermer rreth kompletimit, procedimit dhe aplikimit digjital për subvencione të pagesave direkte në MBPZHR në sektore të ndryshme të bujqësisë ku të gjitha këto procedura janë kryer nga zyrtarët e DBZHE deri të dërgimi i tyre në Agjensionin e pagesave në Prishtinë.
- Furnizimi me shoqëri të bletëve të 60 fermer-bletar me nga 2 bletë gjithsejtë 120 shoqëri të bletëve ku shpërndarja e tyre është bërë në këtë periudhë raportuese me 27.06.2015, vlera e këtij projekti ka qenë 12.200.00 € në bashkëfinancim, Komuna dhe BE (3.000.00 € + 9.200.00 € = 12.200.00 €).
- Hartimi i projektit të serrave në ambiente të mbyllura për vitin 2015, si dhe janë zhvilluar të gjitha aktivitetet rreth këtij projekti, ku kanë aplikuar 27 fermer, ku prej tyre janë përzgjedhur 17 fermer për ndërtimin e serrave prej 2.40 ari (240 m²), financuar nga Komuna e Drenasit, 70 % e projektit, kurse 30 % participim i fermerit, me shumë 42,245.00 €. Ku një serre **2,485.00 € x 17 copë = 42,245.00 €**.
- Është bërë vlerësimi dhe ekspertizat e dëmeve në kulturat e ndryshme bujqësore të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare (të reshurat atmosferike- breshri), dhe janë dorëzuar në MBPZHR për kompensim të këtyre dëmeve për 40 fermerëve.
- Këshillim të fermerve për të gjitha sektoret e lëmisë së bujqësisë.
- Bashkpunimi me IADK-në në sektorin e bujqësisë sipas Memorandumit të nënshkruar.
- Janë mbajtur trajnime me fermeret e lamive të ndryshme bujqësore.

- Tek fermeret është bërë shpërndarja e disa broshurave bujqësore rreth 610 copë.
- Janë lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë 165 Çertifikata (NIF-it) të Regjistrimit te fermerëve.
- Janë mbajtur trajnime me fermer nga: IADK-ja, KDC-ja, Shoqatat Gratë në Biznisë, USAID-i, COSULT INGENEERING etj.
- Është bërë planifikimi i te mbjellurave vjeshtore 2014 – 2015 dhe realizimi i tyre (Mbjelljet vjeshtore të planifikuera për kulturat e ndryshme 4310 ha, dhe prej tyre janë realizuar 4117 ha).
- Planifikimi dhe realizimi i kulturave të ndryshme pranverore (Te planifikuara 2829 ha dhe te realizuara 2478 ha).
- Pregaditja rreth Korrje –Shirjeve me MBPZHR, auto Kombanjeret, fermeret dhe pikat grumbulluse të drithërave në teritorin e Komunës së Drenasit.
- Nga kompania– Ndërmarrja e "IBËR LEPENCË", Njësia e Punës Komoran gjatë këti gjashtë muji të parë te vitit 2014 është punuar në Rregullimin e rrjetit të ujitjes, dhe ndrrimin e pjesëve të dëmtuara ne rrjete në menyra që të zgjerojm sipërfaqet e ujitura, ku tani rrjeti i ujitjes është i aftësuar në mbi 2500 ha.
- Ka filluar realizimi i Projekteve sipas Memorandumit të bashkpunimit me IADK-në dhe "Zhvillimi i Zonave Rulal" përmes Avansimit të Sherbimeve Këshillimorë ku janë indentifikuar temat më të rëndësishme, si problemet ashtu dhe njoftimet të cilat do të jenë të rëndësishme për fermeret. Kjo do ti ndihmojë që fermerët të jenë të informuar për problemet, afatet e kultivimit si dhe mundësit te ndryshme në sherbime bujqësore.
- Janë majtur trajnime me fermer nga: IADK,ESG, KDC dhe USAID. Etj.
- Organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve me fermer për sektor përkatës të bujqësisë.

Subvencionet:

- Shpërndarja e njoftimeve për fermerët rreth aplikimit për pagesa direkte për mbjelljen e grurit, misrit, lule diellit, farë gruri, pemëve dhe perimeve. Ku gjithsejtë kanë aplikuar për subvencionet e grurit dhe misrit janë 650 fermer me sipërfaqe te përgjithshme prej 3009.47 ha (me sip. te grurit 2137.16 ha, me sip. te misrit 697.50 ha, me lule dielli 54.96, me pemë 75.78 ha dhe me perime 44.07 ha), si dhe udhëzimet për fermerët rreth aplikimit DIGJITALIZIMIT dhe udhëzime rreth aplikime te fermerëve për Grande ne MBPZHR për sektorët e ndryshëm bujqësor ku të gjitha procedimet janë kryer në DBZHE.
- Pran Drejtorati për DBZHE janë bërë te gjitha pranimet e aplikacioneve te ndryshme për fermerët qe kan aplikuar për programet e ndryshme qe subvencionohen nga MBPZHR dhe janë kompletuar, proceduar dhe dërguar ne Ministrin e Bujqësisë .
- Të mbjellurat me grurë,subv.150€/ha ku kanë aplikuar 520 fermer, me një sipërfaqe prej 2137.16 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritë ta përfitojnë fermerët tanë është 320,574.00 €
- Të mbjellurat me misër, 150€/ha ku kanë aplikuar 296 fermer, me një sipërfaqe prej 690.86.00 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritë ta përfitojnë fermerët tanë është 103,629.00 €
- Të mbjellurat me lule diell,subv.150€/ha ku kanë aplikuar 1 fermer, me një sipërfaqe prej 54.96 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritë ta përfitojnë fermerët tanë është 8,244.00 €
- Plantacione me pemë,subv.400€/ha ku kanë aplikuar 65 fermer, me një sipërfaqe prej 73.47 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritë ta përfitojnë fermerët tanë është 2,938,800.00 €.
- Ne fushë hapur (perimkultur),subv.300 €/ha ku kanë aplikuar 21 fermer, me një sipërfaqe prej 44.06 ha, ku vlera e përgjithshme e subvencionimit nga MBPZHR qe pritë ta përfitojnë fermerët tanë është 13,218.00 €

- Shpërndarja e njoftimeve për fermerët rreth aplikimit për subvencione të lopëve qumështore, dele, dhive, bletëve dhe për litër të qumështit. Ku gjithsejtë kanë aplikuar për subvencionet e grurit dhe misrit janë 263 në sektor të ndryshëm të blegtorisë dhe bletarisë, si dhe udhëzimet për fermerët rreth aplikimit dhe udhëzime rreth aplikime të fermerëve për Grande në MBPZHR për sektorët e ndryshëm bujqësor.
- Subvencionimi i lopëve nga MBPZHR me nga 75 € për krerë, ku kanë aplikuar 163 fermer me 1185 krerë lopë qumështore, ku shuma e përgjithshme që pritë të përfitojnë fermerët është 88,875.00 €.
- Subvencionimi i deleve nga MBPZHR me nga 15 € për krerë, ku kanë aplikuar 41 fermer me 4315 krerë dele. ku shuma e përgjithshme që pritë të përfitojnë fermerët është 37,450 €.
- Subvencionimi i dhive nga MBPZHR me nga 15 € për krerë, ku kanë aplikuar 15 fermer me 681 krerë dele. ku shuma e përgjithshme është 10,215.00 €.
- Subvencionimi i shoqërive me bletë nga MBPZHR me nga 10 €, ku kanë aplikuar 47 fermer me 2768 shoqëri bletë. ku shuma e përgjithshme që pritë të përfitojnë fermerët është 27,680.00 €.
- Subvencionimi për pula vojse me nga 1.50 € për copë, ku kanë aplikuar 1 fermer, me numër të pulave vojse prej 6000 copa, ku shuma e përgjithshme që pritë të përfitojnë fermeri është 9000.00 €.
- Subvencionimi për litër qumështi me nga 0.06 € per ekstra klas, 0.04 € per klasin e parë, 0.02 € për klasin e dytë, ku kanë aplikuar 4 fermer me 81 krerë lopë. ku shuma e përgjithshme që pritë të përfitojnë fermerët varët nga klasa, në bazë të % së yndyrës dhe në bazë të % së qelizave somatike të qumështit dhe sasia e qumështit që do ta dorëzojnë fermerët në pikën grumbulluese.
- Janë bërë me kohë të gjitha parapërgaditjet për realizimin me sukses të faushatës së korrje-shirjeve ku është formuar Komisioni Komunal për monitorimin e këtij procesi të rëndësishëm. Këtë vit janë për tu korrur 4117 ha dhe për kryerjen e korrjes së drithrave të bardha do të angazhohen 65 autokombajna nga Komuna jonë si dhe autokombajna nga Komunat tjera që më herët e kanë përfunduar fashatën e korrje shirjeve.

SEKTORI I EKONOMISË - Sipas Qendrës Komunale **ONE STOP SHOP** për Biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2015 deri me datën 30.06.2015 janë të regjistrua 141 biznese të reja, krahasuar me periudhën paraprake të vitit 2014 që ishin regjistruar 115 biznese ose shprehur në përqindje **23.00%** më shumë se në gjatë të muajit të kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë 231 punëtorë. Bizneset fillestare brenda ditës paisën me çertifikatën e biznesit, numërin fiskal me deklarim vullnetar paisën edhe me çertifikatën e TVSH dhe çertifikatën doganore, pranë kësaj Qendre ipën të gjitha konsulentat e nevojshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa më të volitshëm për regjistrimin dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

Tabela e klasifikimit të bizneseve sipas numrit të punë

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	141	100.00%
Të mesme	5 - 60	-	-
Të mëdha	60- e më tepër	-	-
Gjithsejt:		141	100.00%

Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2015– 30.06.2015 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (100.00%)

Nr .	Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari:	Shpërndarja e bizn. Sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Tregti	38	27.00%
2.	Transporti	17	12.00%
3.	Ndërtimtari	21	15.00%
4.	Hoteleri	10	7.00%
5.	Bujqësia	21	15.00%
6.	Shëndetësi	11	8.00%
7.	Industri- zejtari prodhuese	14	10.00%
8.	Arsim	9	6.00%
	Gjithësejtë.....	141	100.00 %

Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën

01.01.2015 – 30.06.2015

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	131	93.00%
2	Ortakëri e përgjithshme		
3	Ortakëri e kufizuar		
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	10	7.00%
5	Shoqëri Aksionare		
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj		
7	Ndërmarrje publike		
8	Kooperativë bujqësore		
	TOTALI	141	100.00%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2015 – 30.06.2015 në Komunën e Drenasit. Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me 93.00%. Gjatë periodës 01.01.2015 – 30.06.2015, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: 77 ndryshime të bizneseve ekzistuese ,në periudhën paraprake të vitit 2014 biznesetqë patën ndryshime ishte63biznese ose 22.00% ma pak se në periudhën e njejt të vitit 2015dhe sipas muajve dukën kështu:

Nr.		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali					
1.	Ndryshi met në biznese	12	13	15	12	14	11	77					

Janë regjistruar 32shuarje dhe janë ndërruar 12 certifikata me logo të UNMIK-ut si dhe janë zëvendësuar me certifikata me logo të Republikës së Kosovës . Në periudhen 01.01.2015 - 30.06.2015 janë Arkivu 319landë, janë faturu dhe pagu 55,000.00euro taksë Komunale, janë dorzu raporte për biznese në MTI,konsulenca rreth bizneseve,sistemimi dhe azhurimi i lëndve në foldera dhe programe të caktuara jan shtyp dhe protokolu 493 Aktvendime për taksën Komunale dhe janë dorzu për shpërndarje, sidhe janë kry punë të tjera sipas nëvojës së DBZHE

Sektori i Pylltarisë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Autoriteti Pyjorë Komunal në Drenas ka patur një angazhim pëmanent në mbrojtjen e pyjeve shtetërore dhe private.Ky Autoritet ka koordinuar aktivitetet në një bashkëpunim të ngushtë me Policinë, Gjykatën, Njësinë e zjarrfikësve dhe me Drejtorinë Koordinuese pran APK ne Prishtinë.Mbrojtja e pyjeve në komunën e Drenasit është e kënaqshme dhe mund të themi se është në nivel të lartë të regjionit. Pylltarët së bashku me zyrtarët e këtij Sektori kanë pasur një angazhim të lartë në mbrojtjen dhe menagjimin e pyjeve të Sektorit privat dhe ati Shtetërorë.

.Aktivitetet në Vitin 2014:

-Mbrojtja dhe ruajtja permanente e pyjeve nga prerjet ilegale, -Monitorim i përhershëm.

-Kontrolla pyjore në rajonin e Qyqavicës,Kosmaqit dhe Pallanikut

Si dhe inspektime në tregjet e Drenasit dhe Komoranit.....20 kontrolla.

-Veprimet Silvikulturore (rrallimet) janë kryer në 30 ha.ku për kryerjen e këti aktiviteti janë angazhuar 20 punëtorë sezonal.

-Regjistrimi i dëmeve të pyjeve është kryer në bashkpunim me APK në tri objektet pyjore.

-Pjesmarrja e zurtarve në 6 Seanca në gjykatën Komunale në Drenas.

- Gjithësejtë fletëparaqitje të ngritura 8

*Kunderfajtëse1

*Penale7

*Akvendime të Gjykates që pushuar procedura ...27

*Akvendime të ekzekutauara nga Gjykata16 (9 Kundervajtëse ,7Penale)

*Zjarre në pyje për periudhen raportuese nuk ka patur.

5- DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMËRGJENCË

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë bazuar në Statutin e Komunës nenit 82 mbështetur në kompetencat dhe detyrat që i takojnë, duke respektuar legjislacionin dhe udhëzimet administrative gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 ka pranuar një numër të madh të kërkesave nga qytetarët dhe qëllimi i tyre ka qenë dhe është zgjidhja e tyre në mënyrë sa më efikase dhe në kohë sa më të shpejtë. Lidhja e kontratave me kohë e disa nga projekteve kapitale ka mundur shërbim më të shpejtë dhe me cilësor për intervenimet në teren si psh. mirëmbajtja e ndriçimit publik, renovimi i rrugëve të asfaltuara, mirëmbajtja e hapësirave publike përkatësisht sheshit, zgjerimi i shërbimit në menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror, pastrimi i rrugëve gjatë sezonit të verës dhe kërkesa tjera të vazhdueshme për mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe gropave septike.

DSHPE ka vazhduar kontaktet me qellim të përfitimit edhe me palët e treta ku në bashkëpunim me Organizatën gjermane GIZ, ka siguruar kontejner, për deponimin e mbeturinave në pikën transferuese, shporta për ekonomitë familjare në fshatrat, Nekoc dhe Damanek dhe se fundi ka nënshkruar marrëveshjen në vlerë prej 10.000€ për blerjen e një kamioni për nevojat e grumbullimit të mbeturinave. Falë bashkëpunimit të ngushtë me palët e treta (UNDP "Feronikeli" dhe Komuna) është duke u bërë zëvendësimi i ndriçimit publik me ndriçim solar në sheshin "Fehmi Lladrovci".

Ka filluar implementimi i projektit për mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor, ku vlen të theksohet se përkundër buxhetit të rritur për këtë vit kërkesat janë tejet të shumta. Njësitë e Zjarrfikësve që vepron në DSHPE, vazhdimisht ka qenë në gjendje gatishmërie 24 ore dhe si rezultat i kësaj është vlerësuar shumë efikasiteti në punë i këtij njësi. Ky njësi këtë vit ka pranuar një veturë për intervenime teknike dhe është në procedurë edhe për blerjen e një veture tjetër që do të lehtëson punën e njësitit në teren. Numri i vogël i punëtorëve në këtë drejtori karshi kërkesave të shumta dhe stafi jo adekuat mbetet sfida e vazhdueshme.

Gjatë periudhës Janar-Qershor Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjence ka realizuar këto punë dhe detyra:

- Është hartuar Plani i punës për vitin 2015 për DSHPE/ne
- Janë hartuar të gjitha paramasat për projektet, ku janë dërguar në Prokurim për zhvillimin e procedurave
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror
- Renovimi i gropave të asfaltuara në Komunën e Drenasit
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit të verës
- Është realizuar Projekti për Mirëmbajtja e varrezave
- Është duke u realizuar projekti për: Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit
- Është duke u bërë intervenimi i rrugëve të rendit të IV (katërt) me zhavor
- Projekti për trajtimin e qeneve endacak
- Ndërrimi i dymëve në objektin e shërbimit të zjarrfikësve
- Janë pranuar gjithsej 210 kërkesa nga qytetarët.
- Janë shqyrtuar 38 kërkesa të arritura me rastin e zjarreve, vërshimeve dhe erërave të forta ku edhe është bërë vlerësimi i tyre në teren.
- Janë hartuar 38 raporte për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore

- 31 kërkesa janë shqyrtuar për intervenime në mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe gropave septike,
- 62 Kërkesa për shtrim me zhavorr të rrugëve të rendit të IV
- 7 kërkesa për pengesa në rrugë – ku procedura e këtij projekti është duke u zhvilluar
- 33 kërkesa për pajisje me leje për autotax-i
- Janë përanditur 30 vendime për lejet e operimit Autotax-i , në komunën e Drenasit
- Ndërsa kërkesat tjera janë për pastrimin e deponive , procedura e të cilit është duke u zhvilluar , furnizim me kontejner, po ashtu dhe kërkesa të ndryshme nga qytetarët e Komunës së Drenasit.
- Projekti për furnizim me shenja horizontale dhe vertikale së shpejti pritët lidhja e kontratës
- Projekti për furnizim me kontejner është në procedurë

6 - DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtorati për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës Janar-Qershor/015, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret , vendimet , udhëzimet e MF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Ky Drejtorat, punën e vetë kryesisht e ka orjentuar në këto lëmi:

- plani i punës për vitin 2015,
- raporti i punës dhe financiar për vitin 2014,
- pasqyrëzat financiare 2014,
- procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2016-2018, sipas kërkesave të programeve,
- raportet financiare sipas muajve dhe periodave të vitit /015,
- aprovimi i shpenzimeve dhe çertifikimi për buxhetin komunal sipas programeve ,
- kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës,
- punët lidhur me arkën e parave të gatëshme (arkëtimi dhe pagesat),
- regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK-në,
- autorizimi i shpenzimeve për Drejtoratin për Buxhet dhe Financa,
- përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës,
- përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit-M.F-së,
- caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2015,
- caktimi i taksave dhe ngarkesave tjera,
- evidentimi i objekteve të reja si pasuri e palujtëshme dhe rimatja e objekteve ,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- punët lidhur me zbatimin U.A nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Komunale
- punët lidhur me përgatitjen e propozim vendimeve dhe vendimeve për buxhetin,
- përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018 dhe buxheti 2016-2018,
- përgatitja e rishikimit të buxhetit komunal/015,
- shlyrja e pagesave për tatimin në pronë,
- plotësimi i formularëve për buxhetin 2016-2018, sipas programeve,
- punët lidhur me ridestinimin-transferin e mjeteve buxhetore të vitit 2015,

- në trajnimin e puntorëve të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, tani më është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit-Zyra e Tatimit në Pronë, Thesarit dhe Financave.

1. Sektori i Buxhetit .- Për periudhën raportuese, ka kryer këto punë dhe detyra pune:

- zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2016-2018, sipas kërkesave të programeve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve,
 - përgatitja e Qarkoreve 01/015 dhe 02/015 Interne buxhetore,
 - përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018,
 - vërtetimi i deklaratave të nevojës për sigurimin e parasë publike lidhur me projektet kapitale dhe projektet tjera, para shpalljes së tenderve,
 - përgatitja e formularve PIP-1, të projekteve kapitale,
 - përgatitja e formularve për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve lidhur me buxhetin komunal 2016-2018, sipas programeve,
 - punët lidhur me ridestinimet-transferet e mjeteve sipas nevojës ,
 - përgatitja e planit të zotimit dhe shpenzimit të parasë publike sipas programeve dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve për vitin fiskal 2015,
 - aktivitetet e zhvilluara për organizimin e dëgjimeve buxhetor me qytetarët e Komunës së Drenasit ,
 - përgatitja dhe dërgimi i raporteve në M.F-Departamentin e Thesarit lidhur me faturat e pa paguara sipas muajve,
 - caktimi i taksës për personat që kanë pasuri të luajtshme, në numër prej 5600,
 - numëri i kontratave për transferin e pronës të vertetuara 69 ,
 - për personat që janë pronar- shfrytëzues të pasurisë së palujtëshme (objekte), janë lëshuar 3112 vërtetime,
 - për personat që janë pronar të pasurisë së luajtshme janë lëshuar 5600 vërtetime,
 - numëri i vërtetimeve tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit gjithësejt janë lëshuar 138 vërtetime,
 - numëri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal 799, si dhe zotimi i mjeteve sipas kërkesave,
 - regjistrimi i pagesave të tatimpaguesve përmes arkës 248,
 - lëshuarja e faturave sipas kërkesës së palëve 2970,
 - ruajtja e databases për të dhënat e regjistruara,
 - objektet e reja të matura – rimatura 176,
 - fatura të shpërndara përmes poste 10173,
 - numëri i ankesave të pranuar 54 ,
 - pranimi i kërkesave për verifikimin e objekteve të pa luajtshme 265,
 - regjistrimi i kontratave të shitblerjeve 15,
 - korigjimi manual i pagesave 107,
 - riprogramimi i marveshjeve për pagesë në sistem 112,
 - korigjimi manual i faturave të përlllogaritura gabim 241,
 - modifikimi i të dhënave për cilsinë e objektit në bazë të fotografisë 346,
- Angazhimet e bëra nga Zyra e Tatimit në Pronë-DBF, lidhur me arritjen e një performance të ngritur për arkëtimin e tatimit në pronë, pasqyrohet nëse bëjmi krahasimin e planifikimit **(145.000,00€)** si të hyra vetanake me arkëtimin **(173.297,68€)** i cili paraqet tejkalim të objektivit për **+19%**.

2. Sektori i Thesarit.- Në këtë sektor punët dhe detyrat e punës, janë kryer si vijon:

- numëri i shërbimeve lidhur me arkëtimin e parave të imta për shërbime në Administratë ka qenë 12172, Gjeodezi 3290, Urbanizëm 263,Financa 4226, Shendetësi 574, Arsim 223, Bujqesi 214,Shërbime Publike 144,Z.Kryetarit 96, gjithsej:**21202** shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveq arkëtimit , është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.
- regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në database dhe në sistemin e Free-balancit,
- transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MF për çdo fund muaji ,
- barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
- hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe Ministris së Financave,
- punët lidhur me pasurinë komunale të dhën në shfrytëzim,
- zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, numëri i lëndve 420 dhe sipas modulit të aprovimit, në numër prej: 379,
- kryerja e pagesave nga buxheti i komunës (dhjetë drejtorate dhe tri zyre komunale për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara, në numër prej: 1426. Vlen të cekët se 100% e lëndve të pranuar në zyrën e pagesave janë proqesuar për pagesë. Nëse bëjmi një krahasim të këti shërbimi me periudhën e njëjt të një viti më parë, vërehet se kemi patur zvoglim të lëndve për -15% ,
- kryerja e barazimeve mujore-perjodike me Departamentin e Thesarit ,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektoreve kryesor dhe programeve,
- bazuar në Rregulloren MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore është bërë regjistrimi i pasurive jo financiare kapitale të evidentuara në vlerë prej:**428.517,08€**. Në këtë vlerë janë përfshirë tokat, ndertesat, pajisjet, infrastruktura, si dhe automjetet, pasuri komunale.Pra në SIMFK janë të përfshira të gjitha këto kategori.Duke siguruar dokumentacionin siq edhe kerkohet me Rregullore për të regjistruar një pasuri .

3. Sektori i Financave.- Në periudhën janar-qershor/015, përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:

- çertifikimi-aprovimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyreve komunale me modulin e blerjes, në numër prej 980 lëndë,
- çertifikimi-aprovimi i lëndve për pagesë sipas modulit të aprovimit, në numër prej 446 lëndë,
- përgatitja e regjistrit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar,
- është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e çertifikuara-aprovuara sipas shpenzimeve veq e veq,
- raporti i punës-financiar për vitin /2014,
- pasqyrëzat financiare për vitin /2014,
- raporti i kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale për Ministrin e Financave dhe Kryetarin e Komunës,
- raportet mujore financiare,
- raportet periodike financiare/015,
- plani i punës për vitin 2015
- regjistrimi i të gjitha lëndëve të aprovuara në librin e dorëzimit për arhivë dhe dorëzimi i tyre për arhivim sipas dispozitave ligjore.

Me kërkesën e Departamentit të Thesarit –M.F, punëtoret e këti Drejtorati që përdorin Sistemin Informativ të Menaxhimit Finnciar, janë ri trajnuar dhe Çertifikuar për perdorimin e moduleve përkatëse në Sistem.

Për periudhën raportuese, DBF ka planifikuar të arkëtoi mjete në shumë prej: **190.000,00€**; ndërsa me gjendjen e të dhënave 30.06/015, janë arkëtuar mjete në shumë prej: **221.637,68€**, apo shprehur në përqindje **+16%** më shumë.

Nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa, gjatëperiudhës raportuese, janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar në punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës, si dhe Ministrinë për Financa.

4. Masat e propozuara

Për të qenë sa më efikas në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës, që janë të parapara me Statutin Komunal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, rregulloret dhe vendimet në fuqi dhe programin e punës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa (D.B.F) propozon këto masa:

- vendosjen e adresave dhe numërave në objektet e pa luajtshme në tërëtorin e Komunës së Drenasit,
- informimin e obliguesve të tatimit në pronë që t'i paraqesin ndryshimet eventuale në pronën e tyre siq janë: Ndërtimi i shtëpive dhe objekteve tjera të reja, ndërtimi i destinimit të objekteve për mënyren e shfrytëzimit, si dhe informimi për objektet e rrënuara,
- rritja e stafit në Zyrën e Tatimit në Pronë,
- sigurimi i hapsirave të mjaftueshme për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës për punëtorët e D.B.F,
- vazhdimi i aplikimit të masave për moskryerjen e disa shërbimeve komunale ndaj obliguesve tatimor,
- krijimi i mundësive për stimulimin e punëtorëve në punë,

7 - DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONË

Kjo Drejtori kryen një veprimtari specifike, profesionale të punëve dhe detyrave të punës me interes të përgjithshëm të qytetarëve, personave civil –juridik. Mban evidencën e të gjitha Tokave të Komunës së Drenasit të ndarë në 35 zona kadastrale, lidhjen e Hipotekave dhe Regjistrin të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme kadastrale etazh, kadastrin nëntokësor etj.

Bashkëpunimi i drejtorisë me organe dhe subjekte të tjera të Komunës.

Në kuadër kompetencës së vet teknike profesionale dhe administrative, punën e vetë e kryen në bashkëpunim të ngushtë dhe të përhershëm me kryetarin e komunës, Kuvendin dhe Agjencinë e Kadastrale të Kosovës.

- ✓ Me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit për të gjitha projektet punët gjeodezike janë kryer nga punëtorët e kësaj Drejtorie, sidomos me rastin e ndërtimit të rrugëve Lokale në përkufizimin e tyre dhe heqjen e pengesave të ndryshme.

Spektori i Gjeodezisë - Nga punët e sektorit, është bërë organizimi i tyre, ndarja e detyrave individuale dhe grupe, kontrollimi dhe aprovimi i punëve në aspektin profesional, ligjor dhe financiar. Punimi i informative gjeodezike dhe financiare mujore dhe koordinimi i rregullt dhe ditor me eprorin e organit.

Kërkesat e terenit dhe llojet e tyre në periudhën raportuese:

kërkesa për: **matje, ndarje etj**

48 copë,

vendosje kufiri etj.....	11
regjistrimi i parcelave,pronës	7
identifikimi dhe regjistrimi banesave etj.....	12
koordinata,vektori. etj.....	16
ndërrimi i kulturës,bashkim parcele e tj.....	9
Gjithësejtë :	103

Kërkesat e lëmi për matje ,ndarje dhe regjistrim të pronave që janë 64 sish,realisht të marrin në zyrë dyfishin e kohës në raport me kohen për kryerjen e punëve të terrenit. Nga këto lloje të kërkesave që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me interesat e qytetarëve janë shqyrtuar të gjitha. Në procedurë janë14 kërkesa ,për arsye të ndryshme e sidomos në bazë të kërkesave specifike dhe të arsyeshme të palve. Është duke u punuar në sistemin e ri të punëve gjeodezike ,në kadastrin e koordinatave gjegjësisht në “map system” Përkundër vështirësive evidente që paraqiten në saje të mungesës së planeve të azhurnimit dhe gjendjes së pa azhurnuar , çdo ditë shihen rezultatet pozitive në këtë lëmi. Në bashkëpunim me sektorin e pronës janë vendosë në teren dhe janë përpunuar në aspektin gjeodezik 19 raste. Në disa raste përveç procedurës së rregullt është deshtë me përgatitë informata dhe pergjegjje të veçanta .

Janë vendosur mbi 50. raste të tatimit në pronë.

Janë lëshuar mbi 570 kopje plani

Puna me palë në këtë sektor është mjaft voluminoze dhe me shumë me përgjegjësi .Në periudhën raportuese i kemi pas mbi 2600 palë për nevoja dhe interesa të ndryshme që kishin të bënin me pronat , çështje kontestuese në disa raste shumë të ndjeshme ,bile edhe konfliktuoze për çështje pronësore e tj. Për kryerjen e punëve nga lëmi gjeodezisë janë arkëtuar :8039,00 E. Për kopje të planit janë paguar mbi 3420,00€ .Apo në këtë gjashtëmujorë të hyrat nga realizimi I punëve gjeodezike janë :11 459,00E. Nëse e analizojmë faktin se **5 zona kadastrale** kanë hy në këtë vit në rindërtim ,e që është 1/7 e të gjitha zonave kadastrale sa ka komuna e Drenasit,mandej edhe në sipërfaqet zonën komasative , për mbi 5000 hektar(afërsisht 5 fshatra) i kemi ndërpre punimet në teren,në nivel të organit ,për arsyet se janë në vazhdim punët nga kompania përfituese;Andaj,mund të konstatojmë se edhe realizimi i të hyrave është i mirë. Po vazhdon regjistrimin e ndërtesave,banesave etj edhe në kadastrin etazh,relativisht mirë.

Sektori i Pronës - Në sektorin e pronës I cili kryen detyrat e punës në kuadër të Drejtoratit për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë të Komunës se Drenasit në periudhën raportuese nga muaj Janar I këtij viti e gjerë në fund të Qershorit janë kryer përafërsisht të gjitha detyrat e punës sipas plan-programit të punës për këtë gjashtëmujor. Punët në këtë sektor janë kryer duke i venë në trajtim sipas radhës të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat fizik dhe juridik,por janë kryer edhe shumë punë tjera në vijën e mbrojtjes se pronës komunale edhe sipas detyrës zyrtare (-ex-oficio). Me veprimin tonë në teren gjatë trajtimit të kërkesave për konflikte në mesë të njerëzve kryesisht për rrugë kemi bërë zgjidhje të rastit pa zhvilluar fare procedurë administrative –kur me bindje dhe marrëveshje është liruar prona komunale dhe është shtruar rruga publike me asfalt ku është zgjedhur problemi në të njëjtën kohë.(janë liruar se pakut 20 ari pronë komunale kryesisht për rrugë).

Janë trajtuar në teren dhe në zyrë 19 kërkesa të ndryshme nga personat fizik e juridik rreth pronave. Për secilën kërkesë që është trajtuar në teren është bërë edhe informimi zyrtar. Është zhvilluar procedura administrative për uzurpim të pronës komunale (rrugë publike)ndaj 6 personave në fshatin Tërdec dhe 1 në fshatin Abri dhe janë nxjerr për ta edhe aktvendimet por nuk janë lëshuar ende për shkak se jemi në pritje për vazhdimin e punimeve të rrugës në relacionin Abri-Terdec-Gulluboc. Për këtë çështje është informuar edhe zyra e Drejtorit dhe kryetarit të Komunës,sepse procedura zhvillohet në dy shkallë të vendosjes administrative (dmth. kërkohet kohë dhe rruga

mbetet pa shtruar). Sipas kërkesave të qytetarëve janë lëshuar edhe 2 vërtetime lidhur me shpronësime të mëhershme për nevoja të gurthyesit në Çikëtove të vjetër.

Nga ky sektor në bazë të aktvendimit të nxjerr nga kryetari i komunës është bërë vlerësimi me komision i dëmtimit të pronave në riparimin e largpërçuesit të rrymës elektrike nga ana e KEK-ut në zonën kadastrale në Dobrashec dhe janë lidhur 54 marrëveshje për kompensim me pronarët e pronave të dëmtuara. Janë lëshuar 19 certifikata për ofertat e paraqitura nga shitësit e pronave e që iu kanë drejtuar Komunës për blerje të pronave në shitje, gjithashtu janë lëshuar edhe 19 certifikata për pronat e si objekt i shitblerje se nuk janë prona të nacionalizuara. Është punuar edhe vlerësim të të dhënave në elaboratin e përgatitur për shpronësim të zonës së lumit Drenica. Për të cilin edhe është bërë informim me shkrim. Në këtë sektor në këtë gjashtëmuor është zhvilluar aktivitet i bashkëpunimit edhe me Drejtoratet tjera në kuadër të Komunës së Drenasit dhe me agjencionin kadastrale të Kosovës në Prishtinë. Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesës së drejtorit të Drejtoratit për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.

Punët administrative,

Raporti gjashtë muor për vitin 2015 për regjistrimin e pronës së paluajtshme nga Zyra e Kadastrit.

- 1.Kontrata mbi shitblerjen e pronës së paluajtshme -47 raste,
- 2.Aktvendime të Trashëgimisë -46 raste,
- 3.Kontrata mbi dhurimin -24 raste,
- 4.Aktvendime për Hipotekë -45 raste,
- 5.Aktvendime mbi fshirjen e Hipotekës -13 raste,
- 6.Aktvendime mbi ndarjen e parcelave -15 raste,
- 7.Kontrata të Qirambajtjes-nënqirambajtje për 99 vite-15 raster,
- 8.Kontrata mbi regjistrim banesave-lokale -21 raste,
- 9.Kontrata mbi ndarjen e bashkësisë familjare-6 raste.
- 10.Barra tatimore -2raste
- 11.Korigjime të emrit dhe mbiemrit -13 raste
- 12.Bashkim parcelash -6 raste
- 13.Regjistrim i trolit -1rast dhe 14-raste tjera.

GJITHËSEJT----- 268 raste.

Raporti gjashtëmuor për fletë poseduese dhe certifikata për ndihmë sociale.

Nga data 01.01. deri me 31.01.2015 janë 146 fletë poseduese dhe 396 certifikata për ndihmë, prej datës 02.02. deri me 27.02.2015 janë 185 fletë poseduese dhe 347 certifikata për ndihmë sociale, prej dt.01.03 deri 31.03.2015 janë 699 fletë poseduese dhe 325 certifikatë për ndihmë sociale, prej datës 01.04. deri 30.04.2015 janë 256 fletë poseduese dhe 236 certifikata për ndihmë sociale, prej datës 01.05. deri 29.05.2015 janë 150 fletë poseduese dhe 1297 certifikata për ndihmë sociale dhe prej date 01.06. deri 30.06.2015 janë 154 fletë poseduese dhe 122 certifikata për ndihmë sociale.

8 - DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Aktivitetet kryesore në periudhën Janar – Qershor 2015 për realizimin e prioritetëve.	Performanca kyçe gjatë 6 muorit të parë 2015
Synimi i rritjes për 5% nga planifikimi i fëmijëve që vaksinohen (nga 95% 2011).	- Vaksinimi i fëmijëve (gjashtë muor) 2015: - Të vaksinuar Janar- Qershor : 111220 doza vaksinash (të vaksinuar). - Vaksinimi bëhet sipas Orarit obligativ të përcaktuar nga IKSH.
Zvoglimi i vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë të posalindurve dhe nënave (maternale, para, gjatë dhe pas lindjes) në Maternitet	- Raporti 6 muor 2015 për Maternitet: 90/ lindje - Të posalindur Femra: 49 - Të posalindur Mashkuj: 41 - Të posalindur të vdekur: 0 - Vdekje të nënave gjatë lindjes: 0
Zvoglimi i numrit të personave me kujdes të veçantë - tretman rehabilitues-shërues (Koordinim Institucional DSHMS, QKMF dhe OJQ Handikos - sit).	- Në kontunuitet bëhet identifikimi i personave përmes , Handikosit, Qendrës për punë Sociale si dhe Qendrës për shëndet Mendorë bazuar në bashkësi. - Koordinimi i mirë veprimeve DSHMS me këto Institucione, në këtë 6 muor 2015 Handikosi është ndihmuar me: 5000€, pagesë të qirasë 2 raste si dhe 43 raste trajtime mjekësore 5000 € - 1250 gjithsej persona me aftësi të kufizuara - 57 fëmijë rehabilitohen qendër / Handikos Drenas - 1193 raste rehabilitohen, furnizohen material të nevojshëm ortopedik dhe shëndetësorë në shtëpi.

Aktivitetet kryesore në periudhën Janar – Qershor 2015 për realizimin e prioriteteve.	Performanca kyçe gjatë 6 muajit të parë 2015
*Përmirësimi i shërbimeve emergjente, Lab, Rtg, Maternitet me paisjet dhe aparatura mjekësore diagnostifikim / shërim. *Menaxhimi i situatës Epidemiologjike dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse *Zvoglimi i incidencës së sëmundjeve kardiovaskulare, HIV/AIDS dhe TBC	- Plotësim dhe përmirësimi i resurseve humane të shërbimit me një Doktor (me afat të caktuar) si dhe aktivizimi i projektit në bashkëfinancim Komuna me Caritas Kosova për të sëmurë me nevoja të veçanta (projekt bashkëfinancimi 50+50%). Gjithashtu projekti Marrëveshje Bashkëpunimi “Përkujdesje për shëndetin oral-stomatologjik për persona me gjendje të rëndë ekonomike-sociale” me Team Albania organizat nga Norvegjia - Situatë e qetë epidemiologjike gjatë vitit 2014. Përrjashtimisht 29 raste të dyshuara në tularemi - Këshilla dhe ligjërata lidhur me edukimin shëndetësorë për të zvogluar konsumimin e kripës, yndyrës, sheqerit dhe duhanit etj. Puna me grupe të rrezikuara brenda QKMF-së dhe në teren.
*Përmirësimi i procedurave për qasje në mirëqenjen sociale, qartësimi i kriterëve, përmirësimi i zbulimit të mashtrimit. Rastet e SNS.	- Shtimi i mekanizmit të kontrollit të brendëshëm, bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, Agjencionin Tatimorë të Kosovës si dhe personat shfrytëzues të Skemës Ndhmës Sociale : Gjithsej raste në Skemën Sociale për 6 muajin e parë 1454 raste / Janar-Qershor 2015.

9 - DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Menagjimi, arritjet kryesore, performanca kyqe në periudhen janar-qershor 2015 për realizimin e prioriteteve	- Gjatë kësaj periudhe është bërë menagjimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrave programore inspektuese në kuader të Drejtorisë. - Janë zhvilluar procedura në bazë të Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve në implementimin sa më të mirë të aktiviteteve të kësaj Drejtorie. - Është hartuar plani i punes, raportet, buxheti (kërkesat e para fillestare) si dhe përcjellja e zotimeve dhe shpenzimeve për këtë vit. - Kështuqë gjatë periudhës janar-qershor 2015 në Drejtorinë e Inspeksionit punët dhe detyrat e punës janë kryer me sa vijon: - Inspektimet e subjekteve ekonomike afariste rreth kryerjes së obligimeve (taksave komunale). - Inspektimet dhe mbikëqyrja inspektuese e higjienës, kualitetit të ushqimit, cilësisë dhe afatit të produkteve, kushtet higjenik-sanitare etj. - Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, paisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit, blerjen, shitjen, qmimet, deklaracionin e mallit orarin e punës. - Mbikëqyrja inspektuese rreth ndertimeve, lejeve të ndertimit, lejeve urbanistike, kushteve të punës sigurisë etj. - Inspektimet rreth ndotjes së ambientit, ujrave të zeza, hedhurinave, zhurmë. - Inspektimet në komunikacionin rrugor të udhëtarëve, lejet e operimit, orarin e udhëtimit, parkingjet etj. - Përcjellja e zotimeve dhe shpenzimeve sipas planit buxhetor në këtë Drejtori etj.
Nga lëmia e Inspektorit Financiar	- Inspektimi i rregullt i bizneseve të cilat oeprojnë në teritorin e Komunes së Drenasit, lidhur me kryerjen e obligimeve (pageses së takses Komunale). - Komunikimi i drejtpërdrejt me biznese lidhur me obligimet ndaj Komunes dhe të cilat arkëtohen si të hyra vetanake. - Të hyrat vetanake nga taksat Komunale dukshëm janë rritur dhe krahasuar me periudhen e njëjtë të vitit të kaluar ku janë inkasuar 45.640,00 në këtë periudhë janë realizuar 51.950,00 apo 13,8% më shumë. - Për këtë raportuese janë hartuar 96 procesverbale.
Nga lëmia e Inspektorit Sanitar	- Inspektimet rreth higjenes, kontrolles së përgjithshme të artikujve ushqimorë dhe produkteve të përdorimit të përgjithshëm (Marketet, subjektet afariste hoteliere, sallonet e ondulimit etj) - Kontrolla e higjenes në objektet shkollorë. - Inspektimet rreth zbatimit të Ligjit për kontrollë të duhanit. - Inspektimi i ujit të pijes sipas kërkesave të qytetarëve. - Kontrolla rreth librezave sanitare. - Është bërë asgjësim i mallit me afat të skaduar në vlerë prej 476,17 euro - Janë hartuar 89 procesverbale, 6 Aktvendime dhe janë zgjedhur 8 kërkesa të palëve
Nga lëmia e	Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve.

Inspektorëve të Tregut	• Inspektimet e aktiviteteve tregtare në luftimin e ekonomisë informale, me qëllim të shmangëjes së krijimit të monopolit. • Kontrollë rreth zbatimit të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve. • Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve. • Inspektimet e herëpasëherëshme sipas kërkesave dhe në bashkpunim të MTI-së në bazë të Ligjit t) tregëtisë së brendshme. • Janë hartuar 102, procesverbale, 7 aktvendime, 7 pelqime dhe 7 kërkesa.
Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit	• Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen, instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore. • Inspektimi i kushteve urbanistike (leja urbanistike). • Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore). • Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe pengaditja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale. • Është arritur që shfrytëzuesit e terasave verore (pronë publike) të lidhin kontratë me DPUMM dhe të kryejnë obligimet ndaj Komunës gjithsejtë 13 sosh. • Vlenë të theksohet se që nga dt.01.10.2014 në këtë lemi nuk ka inspektor të ndërtimit andaj edhe ka ngecje në kryerjen e punëve në këtë lemi inspektuese. • Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 77 procesverbale, 27 Aktvendime për pezullim të punimeve, 4 Aktvendime për rrënim të objektit dhe 9 konkluzione.
Nga lëmia e Inspektorit të Ambientit	• Inspektimi i hudhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike. • Inspektimi i mbajtjes së pastërtisë së qytetit. • Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime. • Inspektimet e operatorëve të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit e që janë ndotës të ambientit. • Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj-sidomos në zonat rurale. • Gjithsejtë janë hartuar 45 procesverbale, si dhe janë shqyrtuar 15 kërkesa.
Nga lëmia e Inspektorit të Komunikacionit	• Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombibusët, autotaxit). • Inspektimi i pajisjes së transportuesëve me leje operimi, orar të udhëtimit. • Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë etj, sipas kërkesave dhe në bashkpunim me Policinë e Kosovës-Njësi të Drenas. • Për këtë janë hartuar 9 procesverbale, janë konfiskuar 4 palë tabela dhe 4 librezat të regjistrimit si dhe janë përcjellë në Gjyaktë 3 kërkesa për Kundërvajtje.

10 - DREJTORIA PËR KULTURË, RINI E SPORT

Aktivitetet kryesore në 6-mujorin e parë janar-qershor 2015	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë 6 muajve (janar-qershor) / 2015
Aktivitetet kulturore	▪ U bë hartimi i plan – programit të punës për vitin 2015. ▪ U mbajtë manifestimi për 17 shkurtin ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ku u mbajtë një Akademi Festive, u dha një program kulturo-aristik me këngë e valle nga SHKA „Shotë Galica” . ▪ Me 28 shkurt 2015 në Drenas u mbajtë Akademi Përkujtimore dhe një program kulturor me rastin e 17 vjetorit të betejës së Likoshanit dhe Qirezit. ▪ Manifestimi letrar „Sofra poetike Ymer Elshani 2015” u mbajtë me 16 prill 2015 me fillim në ora 11⁰⁰ në Shtëpinë e Kulturës në Drenas në praninë e shumë adhuresve të fjalës së shkruar dhe me prezencën e një pjese të shkrimtarëve të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës . ▪ U organizua Manifestimi për Ditën e Çlirimit të Drenasit me 14 qershor. Shoqëria mori pjesë me një program të zgjedhur enkas për këtë manifestim në kohëzgjatje mbi dy orë. Programi u mbatë në Sheshin „Fehmi Lladrovci” para një numri të madhë të shikuesve, ku përveq programit nga shoqëria „Shotë Galica” pati edhe mysafirë tjerë të ftuar si: Faik Guraziu nga Prizreni, Zenel Zekolli nga Prizreni, SHKA, „Ymer Alushani” nga Komorani etj. Në këtë mbëmje ishte befasia e këndshme paraqitja në skenë e lojtarëve të KF „Feronikeli” fitues i dyfishtë i kupës së Kosovës dhe kampionit të Kosovës 2014-2015 që ngriti në këmbë të gjithë të pranishmit dhe krijoj një atmosferë të paharruar.. ▪ Arkivi komunal punën e ka kryer në bazë të planit –programit të vet ku gjatë kësaj kohe janë përpunuar 20 kuti me lëndë arkivore dhe gjysëm përpunuar 30 kuti, janë lëshuar 6 qertifikata dhe 12 dokumente për lokale afariste , 4 palë për hulumtime shkencore .Një student ka kryer praktikën dhe janë skanuar 30 dokumente. ▪ Bibloteka në Drenas funksionon ne kushte shumë të mira pas kalimit në objekt të ri.Gjatë kësaj periudhe ka regjistruar 110 anëtar të rinjë dhe ka dhënë në lexim 1577 libra.Ka gjithësejt 315 lexues të rregullt. Bibloteka është pasuruar me 500 ekzemplar të rinjë projekt i bërë nga DKRS dhe e financuar nga Minsitria e Kulturës. Bibloteka e Drenasi i ka dhënë Bibliotekës së Arllatit 30 tituj. Bibloteka në Arllat ka një fond prej 4870 ekzemplarësh, lexues të moshave të ndryshme ka gjithësejt 383 lexues, ka dhënë në lexim 1848 libra. Bibloteka në Tërsetnik ka regjistruar 152 anëtar të rinjë, ka dhënë në lexim 1552 libra. Ka gjithësejt 582 lexues. ▪ SHKA „Shotë Galica” gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në këto festivale: „Flakadani i Karadakut” Viti; e „Anadrija jehon” Dejë; „Hasi Jehon” Gjonaj ; „Eshkë e ndezur mbi Shkelzen” Deqan; „Fushë Arrëz; „Kamza 2015” Tiranë ; „Shkupi 2015” Shkup; „Burimet e Sharrit 2015” Tetovë; „ Revista e Folklorit Burimor ” Mitrovicë; „ Gjirokatër 2015”: ku nga të gjitha këto festivale u kthyer me shperblime. Gjatë periudhës janar-qershor Sektori i Kulturës me rastin e përvjetorëve të dëshmorëve , festave të shkollave fillore, turnireve të ndryshme sportive, akademive, shfaqjeve, koncerteve, bëri dekorimin dhe mbajti zërimin në të gjitha tubimet që u mbajtën në komunën e Drenasit
Aktivitetet sportive	▪ U mbajtë turnir në futboll të vogël me institucionet komunale me rastin e ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. ▪ Me rastin e 28 shkurtit Betejës së Likoshanit-Qirezit u mbajtë turnir në futboll të vogël . ▪ U mbajtë krosi komunal pranëveror ku morën pjesë 14 shkolla fillore dhe dy të mesme. ▪ U mbatën garat e shkollave fillore ne futboll,hendboll (M&F) dhe volejboll(M&F) ku morën pjesë 28 shkolla fillore. Në plasman të përgjithshëm vendin e parë e zuri SH.F.M.U „Rasim Kiqina” Drenas.

- Turniri në futboll të vogël „ Rasim Kiqina ” u mbajtë nga data 30 maj deri me 14 qershor 2015 ku morën pjesë 94 ekipe nga e gjithë Kosova. Këtë vit ky turnir u mbajtë nën patronatin e Kryetarit të Komunës Z. Nexhat Demakut. Vendiin e parë e zuri KF, „ Feniksi” Drenas.
 - U ndihmuan financiarisht të gjitha klubet varsishtë nga kategoria dhe suksesi.Shumë ndeshje u përcollën nga Sektori i Sportit.
 - Këtë vit KF,„Feronikeli” e fitoj kupën e Kosovës dhe u shpall kampion i Kosovës.
 - Ekipi i volejbollit i femrave „Drenasi “ zuri vendin e parë me kategori të re.
- Në garat në nivel të Kosovës të cilat u organizuan në bashkëpunim me shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike u arriten këto rezultate:vendin e dytë në volejboll për femra i takoj Gjimnazit,„Skenderbeu” Drenas. Vendi i dytë në hendboll mashkujt SHMT,„Fehmi Lladrovci” Drenas.

Aktivitetet rinore

- U mbajtën takime me OJQ-të rinore
 - U mbajtë një mbrëmje muzikore për nder të ditës së Çlirimit të Drenasit.
- U përgadit dhe doli ne shtyp revista,„Realiteti” me rastin e 14 qershorit ditës së çlirimit të Drenasit

Kryetari i Komunës
Nexhat Demaku
